



КОМУНА Е ТЕТОВЭС
ОПШТИНА ТЕТОВО
MUNICIPALITY OF TETOVO

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
ОПШТИНА ТЕТОВО - КОМУНА Е ТЕТОВЭС

Бр.-Nr. 20-53771
20-08 2020 год./viti
ТЕТОВО - ТЕТОВЕ



Агенција за вработување на
Република Македонија

Në bazë të Marrveshjes në mes Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë, Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Komunës së Tetovës, Plani operativ për programe aktive dhe masat për punësim dhe shërbime në tregun e punës për vitin 2020 i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Programi për punë të dobishme komunale finansuar nga Buxheti i Agjencionit për punësim të Republikës së Maqedonisë, më 20.08.2020 shpall

Konkurs publik deri te evidenca e personave të papunë për përfshirje në Programin për punë të dobishme komunale

Thirren të gjithë personat e evidentuar si të papunë që janë të interesuar të përfshihen në Programin për punë të dobishme komunale, projekti "Asistentët edukativ në arsimin inkluziv" për angazhim në mardhënie pune me orar të shkurtuar në periudhë prej 9 (nëntë) muajve me qëllim të aftësimit dhe dalëngadalë të përfshirjes në tregun e punës, të paraqiten në Agjencionin për punësim-qendra për punësim në Tetovë.

Personat e evidentuar si të papunë që do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" do të jenë të angazhuar në mardhënie pune me orar të shkurtuar 20 (njëzet) orë në javë, me çrast ky angazhim do të ngelet i pa ndryshuar gjatë periudhës 9 mujore, ndërsa personat e papunë shfrytëzues të ndihmës sociale nuk do të privohen nga shfrytëzimi i ndihmës sociale.

Kanidatët që do të zgjidhen dhe do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" është paraparë që do të paguhet nga 9.000,00 mkd në muaj, ku përfshihet tatimi personal dhe sigurimi në rast të aksidenteve në punë ose sëmundje profesionale.

Personat e evidentuar si të papunë që do të përfshihen në "Programin për punë të dobishme komunale" duhet t'i përkasin njërës nga kategoritë e personave të papunë:

- personat e papunë të evidentuar në Agjencionin për punësim së paku 1 vjet,
- personat e papunë të rrinjë (deri në 29 vjet) të evidentuar në Agjencionin për punësim së paku 6 muaj,
- persona shfrytëzues të ndihmës së garantuar minimale

Pozitat e punës që përfshihen në këtë konkurs u referohen angazhimit të ? personave:

- personat me arsim të kryer sipëror-fakulteti psikologjik
- personat me arsim të kryer sipëror-fakulteti i defektologjisë dhe
- personat me arsim të kryer sipëror-fakulteti pedagogjik



KOMUNA E TETOVES
ОПШТИНА ТЕТОВО
MUNICIPALITY OF TETOVO



Агенција за вработување на
Република Македонија

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

**Fletparaqitja (Personat e interesuar fletparaqitjen mund ta marrin në arkivin e Qendrës për punësim Tetovë).
Diploma e fakultetit (e noterizuar) dhe
Biografi e shkurtër**

Gjithashtu dokumentet e nevojshme duhet t'i dërgojnë në arkivin e Qendrës për punësim Tetovë nga data 20.08.2020 deri më 26.08.2020 nga ora 08:00 deri ora 14:00.

Kushtet më konkrete, të drejtat dhe detyrimet do të rregullohen në kontratën mes Komunës së Tetovës dhe kandidatëve të zgjedhur.

Informata detale të "Programit punë të dobishme komunale mund të meren tek personat Besare Osmani Bilalli, Idriz Shaqiri dhe Besir Ameti që janë kordinator komunal të Programës, Zorica Gjerovska nga Agjencioni për punësim-Qendra për punësim Tetovë dhe Hanife Fetai nga Qendra për punës sociale Tetovë.